



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:203820
Datë: 21.02.2024
Numri i dokumentit: 05355010

AC.nr. 7212/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj - kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike jo kontestimore sipas propozimit të propozuesit K. Sh. nga Prishtina me vendqëndrim në 42 M. R. Southampton, Angli, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati S.B. nga Obiliqi, për shkak të njohjes së vendimit të huaj të lëshuar nga Gjykata Familjare në Londër-Qendra e Shërbimit të Gjykatave dhe Tribunaleve HMCTS Divorci Digjital, të datës 07.09.2022, duke vendosur sipas ankesës së palës kundërshtare K. S. nga Prishtina, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, CN.nr.319/2022, i datës 11.08.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 16.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e palës kundërshtare K. S. nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, CN.nr.319/2022, i datës 11.08.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, CN.nr.319/2022, i datës 11.08.2023, ka vendosur që të: HEDHET poshtë propozimi i parashtruar nga ana e palës kundërshtare K. S. nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar anulimin e klauzolës së plotfuqishmërisë / vërtetimit të përmbarueshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë të evidentuar sipas shenjës CN.nr.319/22 të datës 15.05.2023, si i palejuar.

Kundër këtij aktvendimi pala kundërshtare K. S. nga Prishtina, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, me propozim gjykatës së Apelit që të aprovohet si e bazuar ankesa dhe të ndryshohet aktvendimi i ankimuar, ashtu që të anulohet klauzola e plotfuqishmërisë / vërtetimit të përmbarueshmërisë e vendosur në aktvendimin CN.nr. 319/2022 e datës 15.05.2023.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar propozuesi, me propozim që të refuzohet ankesa e palës kundërshtare, ashtu që të vërtetohet aktvendimi i ankimuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (LPJ) dhe gjeti se:

Ankesa e palës kundërshtare është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi K. Sh. nga Prishtina, me datë 05.10.2022, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur propozim, njohjes së vendimit të huaj të lëshuar nga Gjykata Familjare në Londër- Qendra e Shërbimit të Gjykatave dhe Tribunaleve HMCTS Divorci Digjital, të datës 07.09.2022.

Gjykata e shkallës së parë, pas analizimit të shkresave të lëndës, ka marrë aktvendimin CN.nr. 319/2022 e datës 15.05.2023, me të cilin e ka aprovuar propozimin për njohjen e vendimit të huaj, duke vendosur konkretisht si në aktvendimin e ankimuar.

Pala kundërshtare, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka parashtruar propozim për heqjen e klauzolës së plotfuqishmërisë për aktvendimin CN.nr. 319/2022 e datës 15.05.2023, me datë 07.08.2023, me arsyetim si në propozimin e parashtruar me shkrim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas propozimit të palës kundërshtare për heqjen e vulës së plotfuqishmërisë, ka marrë aktvendimin e ankimuar, CN.nr. 319/2022 datë 11.08.2023, përmes së cilit e ka hedhur poshtë si të pa lejuar propozimin e palës kundërshtare, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të propozimit të palës kundërshtare K. S., me të cilën ka kërkuar heqjen e klauzolës së plotfuqishmërisë së aktvendimin CN.nr.319/22 të datës 15.05.2023, erdhi në përfundim se e njëjta duhet të hedhet poshtë si e pa lejuar.

Më tej ka theksuar se: Deri te një vlerësim i tillë, gjykata erdhi pasi që gjeti se propozimi i parashtruar nga pala kundërshtare nuk gjen mbështetje ligjore ne ndonjë bazë ligjore që mund të gjejë zbatim në rastin konkret. Gjykata e shkallës së parë, vendimin e nxjerrë, me të cilin ka vendosur për një çështje konkrete, i cili është bërë i plotfuqishëm, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore, nuk ka autorizime ligjore ta anuloj. Arsyetimi dhe pretendimi i kundërshtares se propozimit që lidhur me procedurën për njohjen e vendimit të huaj, të aplikohen përshtatshmërisht dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore, konkretisht dispozita e nenit 36 paragrafi 4 i LPP, me të cilën përcaktohet parashihet: *“vërtetimin për përmbarueshmëri të dhënë pa u plotësuar kushtet e parapara me ligj e anulon me aktvendim e njëjta Gjykatë, respektivisht i njëjti organ i pushtetit sipas propozimit të debitorit. Propozimi për anulim duhet të paraqitet brenda afatit prej shtatë (7) ditë nga dita e dorëzimit të aktvendimit përmbarues tek*

debitori. Organi përmbaues ose organi kompetent shtetëror po ashtu mund ta iniciojnë anulimin në çdo kohë”, Andaj, në rastin konkret nuk mund të gjejnë zbatim në këtë rast, ngase procedura përmbaimore është procedurë e veçantë dispozitat e së cilës nuk mund të gjejnë zbatim përshtatshëmrisht në çështjet dhe në procedurën e njohjes së vendimit të huaj.

Më tej ka theksuar se: Gjykata nisur nga këto konsiderata ligjore konsideron se të thënat si më lartë, nuk nënkuptojnë mohimin e të drejtës e ushtrimit të prapësimit të palës kundërshtare në pozitën e debitorit, në procedurën përmbaimore në të cilën kreditori mund të parashtrij propozimin për përmbaimin e aktvendimit të gjykatës për njohjen e vendimit të huaj, e me këtë rrjedhimisht të drejtën e propozimit të shfuqizimit të vendimit të përmbaueshëm, pas argumentimit se vërtetimi për përmbaueshmëri është dhënë pa u plotësuar kushtet e parapara me ligj. Së këndejmi, me dispozitën e nenit 232 të LPK-së është paraparë se procedura e përfunduar me aktgjykim dhe aktvendim të formës së prerë të gjykatës mund të përsëritet sipas propozimit të palës: a) *në qoftë se pala me veprim të kundërligjshëm, e sidomos në rast të mos thirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore”*. Lidhur me nenin 234 të njëjtit ligj, me të cilin parashihet afatit për paraqitjen e propozimit brenda 30 ditësh nga dita kur palës i është dorëzuar vendimit i formës së prerë. Kurse sipas nenit 240 par.2 të LPK-së, përcaktohen autorizimet e gjykatës së shkallës së dytë për anulimin e vendimit të dhënë në procedurën mëparshme.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës jokontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës kundërshtare se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës jokontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet që kanë ndikuar në marrjen e vendimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejt e ka vendosur si në aktvendimin e ankimuar pasi që edhe gjykata e Apelit nga vlerësimi i shkresave të lëndës, por edhe propozimit për heqjen e vulës së plotfuqishmërisë, konstaton se kemi të bëjmë me propozim të pa lejuar, pasi që në rastin konkret nuk mund të zbatohen dispozitat e procedurës përmbaimore përkatësisht nenin 36 paragrafi 4 i LPP, me të cilën përcaktohet parashihet: *“vërtetimin për përmbaueshmëri të dhënë pa u plotësuar kushtet e parapara me ligj e anulon me aktvendim e njëjta Gjykatë, respektivisht i njëjti organ i pushtetit sipas propozimit të debitorit. Propozimi për anulim duhet të paraqitet brenda afatit prej shtatë (7) ditë nga dita e dorëzimit të aktvendimit përmbaues tek debitori. Organi përmbaues ose organi kompetent shtetëror po ashtu mund ta iniciojnë anulimin në çdo kohë”,* dispozitë kjo e cila ka për qëllim heqjen e vulës së

ekzekutueshmërisë së aktgjykimeve apo aktvendimeve të cilat në kundërshtim me dispozitat ligjore është bërë i ekzekutueshëm dhe nuk mund të merret si mënyrë analoge edhe për heqjen e vulës së plotfuqishmërisë, kjo për faktin se në procedurën për njohjen e vendimit të huaj, si palë në procedurë paraqitet propozuesi dhe gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit, komunikimin me palët e bënë vetëm me propozuesin i cili është palë në procedurë dhe nuk mund të komunikoj me persona tjerë të cilët nuk figurojnë të jenë palë në procedurë. Andaj, në rastin konkret nuk mund të flitet për anulim të vulës së plotfuqishmërisë për faktin se gjykata e shkallës së parë në bazë ligjore ka konstatuar plotfuqishmërinë e aktvendimit në fjalë.

Gjykata e Apelit i vlerësoj pretendimet ankimore të palës kundërshtare në lidhje me shkeljen e të drejtave të njeriut me rastin e nxjerrjes së vendimit të huaj përkatësisht vendimin e lëshuar nga Gjykata Familjare në Londër- Qendra e Shërbimit të Gjykatave dhe Tribunaleve HMCTS Divorci Digjital, të datës 07.09.2022, por të njëjtat pretendime nuk i morri për bazë pasi që këto pretendime palët mund ti paraqesin pranë gjykatës kompetente në të cilën është marrë vendimi për të cilin kërkohet njohje dhe jo në këtë procedurë jo kontastimore për faktin se vendimi për njohjen e vendimit të huaj pranë gjykatës së shkallës së parë ka karakter deklarative dhe gjykata e shkallës së parë ka për obligim të vërtetoj se i njëjti vendim a është i formës së prerë dhe jo të lëshohet në vlerësimin e aktgjykimit si gjykatë e faktit, pasi që një gjë e tillë nuk është e lejuar me asnjë dispozita ligjore. Andaj, gjykata e Apelit vlerëson se pala kundërshtare të tilla pretendime mund ti paraqes në gjykatën në të cilën është nxjerrë vendimi për shkurorëzim dhe jo në këtë procedurë për njohjen e vendimit të huaj.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) e LPK-së, e lidhur me nenin 3 të LPJ-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7212/2021, me datë 16.02.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Besnik Bislimaj, d.v